



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN

PLANI STRATEGJIK I KOMUNIKIMIT PËR GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN PËR VITET 2022-2024

Hyrje

Në kuadër të zbatimit të Planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor, miratuar me vendimin nr. 590 datë 26.11.2020, i cili synon përcaktimin e bazave për përmirësimin e marrëdhënieve të gjyqësorit me median dhe publikun, të kuptuarit prej publikut të mjeteve dhe mënyrës së komunikimit me gjykatat, të veprimtarisë dhe shërbimeve që ofrohen nga gjykatat, në zbatimit të Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në zbatim të nenit 91 të tij, i cili parashikon qasjen në drejtësi dhe marrëdhëniet me publikun dhe zbatimit të Ligj nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i cili ngarkon gjykatat me detyrime specifike për të ndërtuar dhe garantuar transparencë mbi veprimtarinë e tyre për palët në proces, grupet e interesit, publikun dhe median si dhe me qëllim rritjen e transparencës së punës së Gjykatave, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan synon arritjen e objektivave dhe përmirësimin e nivelit të besimit të publikut nëpërmjet krijimit të lehtësisë të procedurave për aksesimin dhe marrjen e informacionit në mënyrë eficiente, në kohë dhe brënda afateve ligjore, nëpërmjet zbatimit të Planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor që Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar për sistemin gjyqësor.

Ndaj dhe në hartimin e Planit të komunikimit të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, mbahet në konsideratë dhe vjen si rrjedhojë e zbatimit të objektivave të përcaktuara në Planin Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor, e në këtë kuptim, qëllimi dhe objektivat e këtij plani janë në përputhje me synimet dhe objektivat strategjikë që Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar për sistemin gjyqësor, në zbatim të qëllimit kryesor të Planit Strategjik të Komunikimit i cili synon rritjen e besimit të publikut dhe të transparencës në sistemin gjyqësor nëpërmjet përdorimit të mjeteve dhe mënyrave inovatore të komunikimit dhe informimit midis Gjykatës me median dhe publikun.

Zbatimi i objektivave

Në zbatim të objektivit nr.1, i cili parashtron nevojën për informimin e publikut dhe promovimi i rezultateve të arritura deri më sot për sistemin gjyqësor nga zbatimi i “Reformës në Drejtësi”, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka ndërmarrë këto hapa për realizimin e këtij objekti :

- Hatimin dhe publikimin e materialit informues në format pdf në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në rubrikën “Njoftime për publikun” si dhe në rrjetet sociale Facebook, Twitter, LinkedIn në format jpg dhe video ilustruese, materialin me titull “Fletëpalosje informuese për organizimin e pushtetit gjyqësor” publikuar më datë 24.04.2023, për të informuar publikun për riorganizimin e sistemit gjyqësor.
- Hartimin dhe publikimin e materialit informues, në format pdf në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në rubrikën “Njoftime për publikun” si dhe në rrjetet sociale Facebook, Twitter, LinkedIn, në format jpg, të materialit me titull “Kompetencat tokësore të gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Elbasan” , të publikuar më datë 05.04.2023, i cili përmban informacion në lidhje me pasqyrimin e riorganizimit të kompetencave tokësore të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, publikimi online të grafikës informuese për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, e cila përmban shpjegimin mbi kompetencën tokësore, numrin e gjyqtarëve, infrastrukturën, largësinë.etj të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
- Matja e numrit të shikimeve, pëlqimeve, shpërndarjeve, komenteve të materialeve të publikuara monitorohet nëpërmjet opsioneve të menaxhimit që vetë platoformat e rrjeteve sociale ofrojnë.

Në zbatim të objektivit nr. 2, i cili synon: identifikimin, promovimin, informimin dhe rritjen e

transparencës së sistemit gjyqësor nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit, si mjet novator i komunikimit në mënyrë efikase dhe të shpejtë, mes grupeve të interesit dhe gjykatave dhe të përshtatjes së formës tradicionale të komunikimit të gjykatave me teknologjinë e re, për t'iu përgjigjur kërkesave të publikut dhe nevojave të tyre për një komunikim interaktiv, të shpejtë, efikas dhe cilësor, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka ndërmarrë këto hapa për realizimin e këtij objekti:

- Hartimi, mbajtja e rregullt e të dhënave si dhe publikimi i “Regjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve” për periudhën 19 dhjetor 2022 deri në 31 mars 2023. Në kuadër të transparencës së veriprimitarisë së Gjykatës ky material është publikuar edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në rubrikën “Njoftime për median”, më datë 14.04.2023 si edhe në rrjetet sociale, i cili pasqyron trajtimin e çdo kërkesë të dërguar në postën elektronike të Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun dhe Median, kërkesave të dërguara dhe trajtuara nga Zyra e Arkivës, kërkesave të dërguara në Zyrën e Protokollit të Gjykatës dhe të trajtuara nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median.
- Publikimi në rrjetet sociale i informacionit për përditësimin e llogarive ekzistuese dhe krijimin e llogarive të reja në Twitter dhe LinkedIn, njoftimi bëhet nëpërmjet krijimit të kartës së kontakteve e cila përmban informacionin e plotë të adresës fizike dhe menyrës së kontaktimit të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Karta e kontakteve është publikuar më datë 03.04.2023 në rrejtin social Facebook , në kuadër të lehtësimit të procedurave të aksesit për informacion të publikut dhe grupeve të interesit në mënyrë që marrja e informacionit të arrijë në disa target-grupe që i përdorin këto platforma. Krijimi i kartës së kontakteve të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan u publikua edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në rubrikën “Na kontaktoni”.
- Publikimi në formë narrative të shkruar të materialit se si palë të interesit mund të ndjekin aksesimin e të dhënave statistikore nga palë të interesuara për vitin 2022 për numrin e çështjeve me objekt nenin 130/a. “Dhuna në familje” dhe “Urdhëra të Menjëhershëm Mbrojtje”, material i publikuar në rrjetet sociale në format png dhe format pdf në faqen zyrtare të Gjykatës me titujt: “Statistikat neni 130/ a “Dhuna në Familje”, viti 2022” dhe “Statistikat për ligj nr.9669, neni 10

dhe 13 “Urdhëra Mbrotjtje” viti 2022”, publikuar më datë 06.03.2023.

- Hartimi dhe publikimi i materialit informues i afishuar në rrjetin social Facebook për informimin e grupeve të interesit mbi përdorimin, mënyrën e kërkimit dhe marrjes së informacionit në faqen zyrtare të www.gjykata.gov.al, duke synuar lehtësimin e procedurave për informimin e publikut dhe promovimin e faqes së internetit të gjykatës së rrethit gjyqësor Elbasan.
- Përditësimi i faqes zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me publikimin e listave të gjykimit, shpalljeve publike, lajmërimeve përmes afishimit, publikimin periodik të shortit etj, duke ndihmuar kështu grupet e interesit për të patur një akses më të lehtë dhe më të thjeshtë në marrjen e informacionit për të cilin shprehin interes.
- Në kuadër të informimit të publikut dhe palëve të interesit për aksesimin sa më të lehtë të kontakteve të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median, krijoi Kodin QR për pasqyrimin e të gjithë kontakteve me lidhjet përkatëse të adresave të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Informimi u bë publik duke shpjeguar gjithashtu në rrejetet sociale edhe hapat që duhet të ndjekin grupet e interesit për skanimin e Kodit QR, i cili gjendet i inkorporuar edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në rubrikën “Na kontaktoni” dhe në hyrje të aksesimit të faqes së website të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
- Publikimin e materialeve informuese për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të realizuara nga Klgj dhe zyrat e shërbimit, në rrjete sociale dhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në rubrikën “Njoftime për publikun” e publikuar më datë 13.01.2023.
- Njoftim për përcaktimin e orareve të shërbimeve ndaj publikut të miratuar nga Zv/Kryetaria e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan znj. Matilda Fetau, njoftim i publikuar në rrjetin social Facebook dhe në faqen zyrtare të Gjykatës më datë 13.01.2023.
- Publikimi në formë narrative të shkruar në rrjetin social Facebook të materialit informues se si mund të aksesojnë informacionin për statistikat e plota të 5 viteve të fundit Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, duke bashkëlidhur lidhjet që të drejtojnë në aksesimin e të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të Gjykatës.

Në zbatim të objektivit nr.3, i cili synon informimin e publikut me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, mbi funksionet, veprimtarinë e gjykatave dhe mënyrën se si mund t'i drejtohen gjykatës janë marre këto hapa zbatimi:

- Publikimi në formë narrative nëpërmjet fletëpalosjeve elektronike dhe nëpërmjet publikimit të hapave konkret me foto të rubrikave të faqes zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, mbi procedurën dhe hapat që duhen ndjekur për paraqitjen e kërkesëpadisë nëpërmjet postës në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan si edhe materilait informues të publikuar në rrjete sociale dhe në faqen zyrtare të Gjykatës me titull “Fletëpalosje informuese si ti drejtohem gjykatës me një kërkesëpadi” publikuar më datë 24.01.2023.
- Publikimi në formë narrative dhe publikimin në format png i ligjit mbi procedurën dhe hapat që duhet të ndjekin mediat dhe palët e interesuara për të patur mundësinë e pjesmarrjes së tyre në seanca gjyqësore, duke i bashkëlidhur materialit informues dhe urdhër Nr.6777/5, datë 30.9.2010 për miratimin e rregullores "Për Marrëdhënien e Gjykatës me Publikun" duke cilësuar që informacionin për mënyrën e ndjekes së seancave gjyqësore nga media ti referohen seksionit IV “Marrëdhënia e Gjykatës me Median” të këtij urdhëri, për tu njofur mbi procedurat që ndiqen nga Gjykatat e Shkallës së Parë dhe Gjykatat e Apelit për ndjekjen e seancave gjyqësore nga media, publikuar në rrjetin social Facebook më datë 13.03.2023.
- Publikimi në rrjete sociale të fletëpalosjeve informuese për shërbimet që ofrojnë gjykatat për qytetarët nëpërmjet materialeve të përgatitura nga KLGJ, të publikuara në faqen zyrtare të Gjykatës në rubrikën “Njoftime për publikun”, më datë 13.01.2023.
- Publikimin në rrjete sociale dhe në faqen e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan të fletëpalosjeve informuese me titull “Përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore. Kush dhe si mund ti përfitojë ato?”, materiali i publikuar më datë 01.03.2023.
- Publikimin në rrjete sociale dhe në faqen e Gjykatës të fletëpalosjeve informuese për “Ndihmën juridike të garantuar nga shteti si një e drejtë themelore”, materiali i publikuar më datë 01.03.2023.

- Hartimi dhe publikimin në rrjete sociale të fletëpalosjeve informuese “Si ti drejtohem gjykatës me një kërkesë padi”, materiali i publikuar në rrjetin social Facebook më datë 24.01.2023.
- Hartimi dhe publikimin në rrjete sociale të fletëpalosjeve informuese për “Tarifat në lekë për veprime e shërbime që kryhen nga administrata Gjyqësore e Prokuroria”, material i publikuar në rrjetin social Facebook më datë 24.01.2023.
- Hartimi dhe publikimin në rrjete sociale të fletëpalosjeve informuese për “Rregulla të përgjithshme sjelljeje brenda ambjenteve të Gjykatës”, material i publikuar në rrjetin social Facebook më datë 24.01.2023.
- Hartimi dhe publikimin në rrjete sociale të fletëpalosjeve informuese për “Si të hapni një çështje civile”, material i publikuar në rrjetin social Facebook më datë 24.01.2023.
- Në kuadër të transparencës së veprimtarisë së gjykatave si dhe me qëllim lehtësimin e procedurave për aksesimin e të dhënave nga palë të interesuara, kemi informuar publikun nëpërmjet materialeve të paraqitura në formë narrative mbi mënyrën e depozitimit të kërkesave për informacion në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, duke rekomandur përdorimin e formularit elektronik FEA dhe duke shpjeguar në formë narrative në rrjetet sociale procedurën e plotësimit të tij dhe vendodhjen e formularit duke publikuar lidhjen që mundëson aksesimin në mënyrë direkte me adresën e faqes zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, si dhe depozitimi e kërkesave nëpërmjet postës elektronike dhe formularit të kërkesave në Zyrën e Arkivës.
- Videot shpjeguese janë të publikuara në faqen zyrtare të Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan më herët, i kemi risjellë në vëmndje të publikut disa prej tyre duke i bashkëlidhur shpjegimin e tyre në formë narrative në rrjetet sociale .
- Publikimin e informacionit në rrjetet sociale mbi mënyrën e paraqitjes së kërkesave të palëve të interesuara për mënyrën e depozitimit të tyre në postë, material i publikuar në rrjetin social Facebook më datë 10.03.2023.
- Publikimin e informacionit në rrjetet sociale në formë narrative të shkruar dhe me video ilustruese për mënyrën e plotësimit të FEA-s (Formular Elektronik Aplikimi) publikuar më datë 23.03.2023.
- Publikimin e informacionit në rrjetet sociale në formë narrative të shkruar dhe me foto ilustruese për marrjen e “Informacion mbi Shortin” nga palët e interesuara, publikuar në rrjetin social Facebook më datë 23.03.2023.

- Publikimin e informacionit në rrjetet sociale në formë narrative të shkruar dhe me foto ilustruese për marrjen e “Kalendarit të seancave gjyqësore” nga palët e interesuara, publikuar në rrjetin social Facebook më datë 27.03.2023.
- Promovimin e webfaqes nëpërmjet videove ilustruese për mënyrën e marrjes së informacionit, material i publikuar në rrjetin social Facebook datë 25.01.2023.
- Publikimin e informacionit në rrjetet sociale në formë narrative të shkruar për procedurën e aksesimit në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor për të marrë informacion për përdorimin e infopoint të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për orientimin në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ilustruar me video të realizuara më herët nga IT Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Në zbatim të objektivit nr.4, i cili synon informimin e publikut, veçanërisht të grupeve në nevojë dhe të miturve, lidhur me ndihmën juridike të garantuar nga shteti dhe tarifat gjyqësore janë ndërmarrë këto hapa zbatimi:

- Në kuadër të bashkëpunimit dhe forcimit të komunikimit më palë të interes u publikuan në rrejte sociale dhe në faqen zyrtare Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan fletëpalosje dhe bashkëlidhur informacion në forme narrative i nismës së Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC) në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë, në kuadër të zbatimit të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), publikimin e informacionit për hapjen e Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore për kategoritë e veçanta dhe individët në nevojë, në Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, duke shpjeguar në mënyrë të shkruar dhe afishuar fletëpalosje informuese mbi :
 - Shërbimin ligjor falas për kategori më të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme si dhe kategori të veçanta .
 - Shërbimet që mund të përfitoni pranë kësaj qendre
 - Individët që e përfitojnë ndihmë ligjore falas pranë kësaj qendre
 - Kategoritë që e përfitojnë shërbim ligjor falas pranë kësaj qendre
 - Informacion mbi të dhënat e kontaktit për Ndihmën Juridike Falas në Elbasan

- Publikimin në rrjete sociale të fletëpalosjeve informuese për zyrat e shërbimit për Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të përgatitura nga Klgj, materiale të publikuara në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare më datë 19.04.2023
- Hartimi dhe publikimi i materialit me titull “Ligj. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës””, i publikuar në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të Gjykatës në rubrikën “Njoftime për publikun”, më datë 11.04.2023 në format pdf dhe video ilustruese.
- Hartimi dhe publikimi i materialit informues me titull “Personat me aftësitë kufizuar dhe ligj nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të Gjykatës në rubrikën “Njoftime për publikun”, më datë 20.04.2023.
- Hartimi dhe publikimi i materialit informues me titull “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të Gjykatës në rubrikën “Njoftime për publikun” më datë 24.04.2023.
- Hartimi dhe publikimi i materialit me titull “Ndërmjetësimi, forma e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve pa gjykatë”, në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të Gjykatës në rubrikën “Njoftime për publikun” më datë 27.04.2023.
- Hartimi dhe publikimi i materialit me titull “Material informues ankimi, rekursi, kërkesa për rishikim”, në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të Gjykatës në rubrikën “Njoftime për publikun” më datë 03.05.2023.

Në zbatim të objektivit Nr:5 i cili synon përforcimin e komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet gjykatave dhe medias, OShC-ve, palëve të tjera të interesit janë ndërmarrë këto hapa verpimi :

- Mbajtja e kontakteve me përfaqësues lokal të medias për dhënien e informacionit për çështje për të cilat kanë shprehur interes nëpërmjet kërkesave të drejtuara në postën elektronike të Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun dhe Median.
- Ndërtimin e një komunikimi eficient përmes postës elektronike të Zyrës së Marrëdhënieve të Publikut dhe Medias, me grupet e interesit siç janë palët në proces apo përfaqësuesit e tyre ligjor, për përcjelljen në kohë të kërkesave për shtyrje të seancave gjyqësore në Gjykatën shkallës së

Parë të juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe dhënies në kohë të përgjigjeve të kërkesave/ankesave për informacion mbi çështjet .

- Mbajtja e kontakteve me përfaqësues të institucioneve arsimore të Rrethit Elbasan, për lehtësimin e procedurave për krijimin dhe zhvillimin e aktiviteteve informuese për grupet e interesit.

Në zbatim të objektivit nr: 6, i cili ka për synim afrimin e komunitetit me Gjykatat përmes organizimit të aktiviteteve publike dhe fushatave ndërgjegjëse që kulmojnë në "Javën e Drejtësisë" janë ndërmarrë këto hapa veprimi:

- Hartimi dhe publikimi i materialit informues në format jpg në rrjetet sociale dhe në format pdf në faqen zyrtare të gjykatës me titull "Trashëgimia kulturore juridike e Republikës së Shqipërisë", i cili pasqyron njohuri mbi kuptimin kulturor juridik të datës 10 maj 1913, e cila është "Dita Kombëtare e Drejtësisë", në Republikën e Shqipërisë, materiali i publikuar në rubrikën "Njoftime për publikun" më datë 07.04.2023.
- Hartimi i një posteri promovues për datën 10 maj 1913, publikuar më datë 31.03.2023 në rrjetin social Facebook.
- Përdorimin e vazhdueshëm të hashtagut #Javaedrejtësisë, #Kanunizhursë, #10maj1913, në kuadër të promovimit të "Ditës Kombëtare të Drejtësisë" dhe informimit të publikut në lidhje me trashëgiminë e kulturës juridike të shtetit të pavarur shqiptar.
- Krijimi i logos së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në kuadër të festimit të 110 vjetorit të aktit të parë juridik "Kanoni i Zhursë" i shpallur nga qeveria e Ismail Qemalit, më datë 10.05.1913, si akti i parë juridik që hodhi themelet e organizimit të pushtetit gjyqësor në shtetin e pavarur shqiptar.
- Zhvillimi dhe pjesëmarrja në aktivitete të cilat kanë nisur të zhvillohen në kuadër të "Javës së Drejtësisë", që më datë 23.03.2023 dhe kulmojnë më datë 10.05.2023, datë e cila përkon me "Ditën Kombëtare të Drejtësisë", aktivitete të cilat janë pasqyruar në rrjete sociale dhe në faqen zyrtare të Gjykatës në Rubrikën "Njoftime për publikun" të renditura si më poshtë :
- Në kuadër të forcimit dhe shkëmbimit të ekperiencave me institucionet, Kryetaria e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Znj. Matilda Fetau me datë 23.03.2023 mori pjesë në një takim të zhvilluar nga Fondacionin "Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i

Mosmarrëveshjeve”, financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim në partneritet me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve, ku të ftuar ishin Specialistët e QNJ P Elbasan së bashku me Dhomën e Avokatisë Elbasan, me tematikë “Mekanizmi i Referimit të Çështjeve në Ndërmjetësim”. Në këtë takim u bë i mundur shkëmbimi i eksperiencave dhe u forcua edhe më tej bashkëpunimi në referimin e rasteve.

- Në kuadër të zhvillimit dhe forcimit të komunikimit si edhe bashkëpunimit ndërmjet gjykatave me palë të interesit, Zv/Kryetaria e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan Znj. Matilda Fetau në bashkëpunim me përfaqësues të Fakultetit Ekonomik të Universitetit “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, mundësuan më datë 24.03.2023 pjesëmarrjen për ndjekjen e senacave gjyqësore për studentët e vitit të III-të, dega Master Shkencor në “Drejtësi”.
- Në kuadër të “Ditës Kombëtare të Drejtësisë”, me synim realizimin e aktivitete informuese, edukuese dhe ndërgjegjësuere për brezat e rinj, Zv/Kryetaria e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan Znj. Matilda Fetau, më datë 07.04.2023, mundësoi pjesëmarrjen në aktivitetin e konceptuar si “Orët e Hapura në Gjykatë” me nxënës të Shkollës së Mesme “Dhaskal Todri” në Elbasan, ku të rinjve iu krijua mundësia e aksesimit në ambjentet e brendshme të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan të dedikuara jo vetëm për publikun por dhe në ambjentet e brendshme të dedikuara vetëm për personelin e Gjykatës, duke mundësuar kështu krijimin e një panorame të qartë dhe reale mbi organizimin e strukturës së godinës së Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për ti ardhur në ndihmë të rinjve të organizojnë më mirë idetë e tyre për zhvillimin në karrierë. Në fund të aktivitetit Zv/Kryetaria e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan Znj. Matilda Fetau, mbajti një fjalim përmbyllës me nxënësit e Shkollës së Mesme “Dhaskal Todri”, duke dhënë një panoramë të qartë të njohurive të përgjithshme me tematikë “Organizimi dhe Funksionimi i Pushtetit Gjyqësor”. Materiali është publikuar në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të Gjykatës më datë 07.04.2023 në rubrikën “Njoftime për publikun”.
- Në kuadër të “Ditës Kombëtare të Drejtësisë”, që përkon me 110 vjetorin e Kanunit të Zhurisë Zv/Kryetaria e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan Znj. Matilda Fetau, Gjyqtari i Medias Z. Elton Frashëri dhe Gjyqtarët Z. Elis Dine dhe Znj. Idush Maliqi, pranuan ftesën për pjesëmarrje në aktivitetin që do të zhvillohet më datë 10.05.2023 ora 12:30, në tryezën e diskutimit të organizuar nga Universiteti “Aleksandër Xhuvani” dhe Prokuroria pranë Gjykatës


së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, me tematikë “Sfidat e Drejtësisë Shqipatare nga “Kanuni i Zhurisë” deri në “Reforma në drejtësi” në kuadër të proceseve integruese ,Gjyqësori dhe të drejtat themelore”. Pjesëmarrës të kësaj tryeze diskutimi do të jenë dhe Kryetari i KLP, Rektori i Universitetit të Tiranës, Rektori Universitetit të Elbasanit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë etj. Materiali do të publikohet në vazhdim pas përfundimit të aktivitetit.

Shtojcë

Bahkëlidhur materialit ju dërgojmë :



1. Logo e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan e krijuar në kuadër të 110 vjetorit të “Ditës Kombëtare të Drejtësisë”.



2. Kodi QR i Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan i krijuar në kuadër të 110 vjetorit të “Ditës Kombëtare të Drejtësisë”.



GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM ELBASAN

ZYRA MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN DHE MEDIAN

- www.gjykata.gov.al
- manjola.kume@gjykata.gov.al
- Zmp Gjykata Elbasan
- Gjykata Rrethit Gjyqësor Elbasan
- Gjykata Rrethit Gjyqësor Elbasan
- Gjykata Rrethit Gjyqësor Elbasan
- Lagja 5 Maji, Rruga Koço Brisku, Elbasan, Shqipëri

3. Karta e kontakteve të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, krijuar në kuadër të 110 vjetorit të “Ditës Kombëtare të Drejtësisë” dhe lehtësimit të procedurave për akses në informacion nga publiku.

FALEMINDERIT

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN

Konceptoi ZMP : Manjola Kume